



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE



ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT - Njoftim për mediumet -

Shkup, 11.01.2023

Reforma në gjyqësor e realizuar me 20% të mjeteve të planifikuara buxhetore

Në kuadër të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga mjetet e planifikuara në shumë totale prej 366 milion denarë për financimin e 15 masave, deri me 31.12.2021, janë realizuar rreth 74 milion denarë, gjegjësisht 20%.

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e suksesit me temën „Efektiviteti i zbatimit të Strategjisë për reforma në sektorin e gjyqësorit 2017 – 2022 dhe zbatimit të Plan Veprimit të Strategjisë” në pajtim me Programin Vjetor të ESHR-së për vitin 2022.

Qëllimi i revizionit të kryer ishte dhënia e përgjigjes: ***Masat dhe aktivitetet e përcaktuara në Planin e Veprimin, a kontribuojnë për realizimin e qëllimeve nga Strategjia për reforma në sektorin e gjyqësorit 2017 – 2022?***


Strategjia për reforma në sektorin gjyqësor 2017-2022 është bazë për vazhdimin e reformave në sektorin e drejtësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut në drejtim të plotësimit të rekomandimeve të dhëna në Raportet për progres të vendit nga Komisioni Evropian, kapitulli 23 – Gjyqësori dhe të drejtat fundamentale në rrugën e procesit të integritimit evropian.

Me revizionin është konstatuar se prej **130 masave** të përmbledhura në Strategjinë dhe Planin e Veprimit, vetëm **52% janë realizuar plotësisht**, **34% pjesërisht** dhe **14% janë të porealizuara**.

Gjendja e tillë vjen si pasojë e përcaktimit joadekuat të masave për realizimin e qëllimeve, mungesa e indikatorëve të qartë dhe të matshëm, afatet joreale, vlersimi i burimeve të mjeteve financiare, koordinim i pamjaftueshëm i institucioneve/trupave kompetente bartës të masave dhe aktiviteteve.


Me përgatitjen dhe miratimin e Strategjisë me Planin e Veprimit për periudhën 2017-2022, janë paraparë implikime fiskale nga Buxheti i RMV-së për periudhën 2018-2021, si dhe mjetet e planifikuara nga IPA dhe ndihma të tjera të huaja.

Nga revizioni i kryer dhe analiza e të dhënave nga MD, MF-FQML dhe KBGJ, në kuadër të **Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga mjetet e planifikuara në shumë totale prej 366 milion denarë** për financimin e **15 masave**, deri më 31.12.2021, gjithsej janë realizuar rreth **74 milion denarë**, gjegjësisht **20%**



Shkalla e ulët e realizimit të mjeteve të planifikuara është për shkak të mos realizimit të mjeteve të parapara për masën **2.2.8-2-Ndërtimi i kushteve të reja hapësinora**, që paraqet **40%** të mjeteve të parapara, si dhe mos shfrytëzimi në tërësi të mjeteve të parapara me masën **4.1.3.5-1 – Prokuroria Publike e RMV-së për ndarje dhe rregullim të hapësirës së PP nga gjykatat**, ku janë planifikuar më shumë mjete nga të nevojshmet për 15%.

**Masat nga Plan i Veprimit për vitet
2017-2022 të financuar nga
Buxheti i RMV-së**



Në bazë të monitorimit dhe raportimit për zbatimin e aktiviteteve për plotësimin e qëllimeve nga Strategjia, revizorët konstatuan mangësi në funksionimin e trupin kompetent Këshilli për monitorimin e implementimit të Strategjisë, si dhe në funksionimin e tij pa Metodologji të përcaktuar për monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve nga aktivitete dhe masat e zbatuara, me qëllim vlerësimin e shkallës së matjes së qëllimeve të arritura dhe të realizuara.

Me revizionin e zbatuar është arritur bindje e arsyeshme se masat dhe aktivitetet e përkufizuara në Planin e Veprimit pjesërisht kontribuojnë për realizimin e qëllimeve të Strategjisë për reforma në sektorin e gjyqësorit për periudhën 2017-2022.

Kontaktet për shtyp:

Albiona Mustafa Muhaxhiri +389 72228 203

albiona.mustafa@dzt.gov.mk

Mijallçe Durgutov +389 70 358 486

mijalce.durgutov@dzt.gov.mk

Martin Duvnjak +389 75 268 517

martin.duvnjak@dzt.gov.mk